# UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË
# FAKULTETI EKONOMIK

| Programi mësimor i lëndës (Syllabusi) | | |
|---|---|---|
| **Fakulteti:** | Fakulteti Ekonomik | |
| **Programi/Departamenti:** | Biznes dhe Menaxhment.<br>Specializimi: Banka, Financë dhe Kontabilitet | |
| **Niveli:** | Bachelor | |
| **Kodi i lëndës:** | | |
| **Lënda:** | **FINANCA** | |
| **Statusi i lëndës:** | | Obligative |
| **Semestri:** | | Dimëror |
| **Fondi i orëve:** | 3+1 | Sipas programit të aprovuar |
| **ECTS:** | 7 | Sipas programit të aprovuar |
| **Orari/Salla** | Salla 403 / Amfiteatër 2 | |
| **Viti akademik:** | 2021-2022 | |
| **Mësimdhënës/e:** | Prof. Asoc. Dr. Qazim TMAVA | |
| **Asistent/e:** | Besë SADIKAJ, PhD.C | |
| **Kontaktet:** | Mësimdhënës/e | Asistent/e |
| E-mail: | qazim.tmava@umib.net | bese.sadikaj@umib.net |
| Telefon: | | |

| | |
|---|---|
| **PERMB AJTJE** | Ky kurs synon t'u jap studenteve njohuri mbi konceptet themelore në shkencën e financës. Kjo lëndë studentëve do t'u ofrojë njohuritë themelore mbi teorinë, metodat dhe problemet e financave bashkëkohore, krijimin dhe menaxhimin e parasë dhe aseteve të tjera financiare midis firmave dhe tregjeve financiare me theksim të veçantë në instrumentet e tregut të parasë dhe kapitalit. Gjithashtu do te trajtohet sistemi kreditor, potenciali kreditor dhe procesi i multiplikimit monetar dhe kreditor si dhe efektet ne ekonomi. Politika monetare dhe kreditore si dhe dukuritë financiare makroekonomike si: inflacioni, deflacioni por edhe efekti i qarkullimit ndërkombëtar te pagesave si dhe sistemi monetar ndërkombëtar do te jene objekt trajtimi. |

| | |
|---|---|
| **QËLLIMI** | **Qëllimet kryesore të lëndës janë:**<br>1. Që studentët të jenë në gjendje të analizojnë vendimet kritike nga një perspektiv financiare,<br>1. Të kuptojnë se si të menaxhojmë burimet financiare,<br>2. Të kuptojnë botën e financave. Çdokush i përfshirë në menaxhimin e një biznesit duhet të ketë të paktën njohuri minimale në fushën e financave;<br>3. Të prezantojnë konceptet themelore financiare si vlerën në kohë të parasë, vlerësimin e aseteve, rrezikun dhe kthimin, buxhetimin e kapitalit etj.<br>4. Te kuptojnë sistemin kreditor potencialin kreditor si dhe politiken kreditore, por edhe te fitohen njohuri mbi multiplikimin monetar dhe kreditor si dhe efektet ne ekonomi.<br>5. Te fitojnë njohuri mbi konceptet financiare makroekonomike: inflacioni, deflacioni si dhe efektet ne ekonomi, por edhe masat për luftimin e tyre.<br>6. Te kuptojnë Sistemin Monetar Ndërkombëtar si dhe efektet e parasë ne qarkullimin e pagesave ndërkombëtare. |
| **ARRITSHMËRIA** | **Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:**<br>1. **Të fitojnë** njohuri të thelluara të financave, vlerën kohore te parasë si dhe riskun dhe kthimin,<br>2. **Të përshkruajnë** rolin dhe rëndësinë e tregut financiar, si dhe ndërmjetësve financiar ne ekonomi.<br>3. **Të analizojnë** se si të krijojnë dhe të menaxhojnë në mënyrë efecientë mjetet financiare në tregun financiar, por edhe të jenë në gjendje të vlerësojnë rrezikun në investime.<br>4. **Të argumentojnë** çështjet kritike mbi procesin e menaxhimit të rreziqeve të ndryshme: si rrezikun e kursit të këmbimit, të normës së kamatës, dhe ti zbatojnë në praktike.<br>5. **Të vlerësojnë** gjendjen dhe të interpretojnë qarkullimin e parasë si dhe masën monetare, dhe efektet e saj ne ekonomi.<br>6. **Të interpretojnë** sistemin kreditor, potencialin kreditor te bankave, si dhe efektin e multiplikimit monetar e kreditor ne ekonomi.<br>7. **Të zbatojnë** procesin kreditimit që nga nevoja për kreditim deri tek disbursimi dhe shlyerja e tij.<br>8. **Të krijojnë** analizat mbi Sistemin Monetar Ndërkombëtar si dhe efektet e parasë në qarkullimin e pagesave ndërkombëtare. |

<table>
<tr><td rowspan="16">PROGR AMI</td><td>Javët</td><td>Tema</td></tr>
<tr><td>Java - I</td><td>Prezantim i përmbajtjes së lëndës – (Shqyrtimi i Syllabusit)</td></tr>
<tr><td>Java - II</td><td>Hyrje në financa</td></tr>
<tr><td>Java - III</td><td>Sistemi financiar dhe Institucionet financiare</td></tr>
<tr><td>Java - IV</td><td>Vlera kohore e parasë</td></tr>
<tr><td>Java - V</td><td>Qarkullimi i parasë dhe masa monetare</td></tr>
<tr><td>Java - VI</td><td>Vlerësimi i gjendjes financiare</td></tr>
<tr><td>Java - VII</td><td>Risku dhe Kthimi</td></tr>
<tr><td>Java - VIII</td><td>Testi i Parë</td></tr>
<tr><td>Java - IX</td><td>Sistemi Kreditor</td></tr>
<tr><td>Java - X</td><td>Potenciali kreditor i bankave komerciale dhe Multiplikacioni kreditor dhe monetar</td></tr>
<tr><td>Java - XI</td><td>Politika monetare dhe kreditore</td></tr>
<tr><td>Java - XII</td><td>Inflacioni dhe Deflacioni. Devalvimi dhe Revalvimi</td></tr>
<tr><td>Java - XIII</td><td>Paraja ne qarkullimin ne pagesave ndërkombëtare</td></tr>
<tr><td>Java - XIV</td><td>Sistemi Monetar Ndërkombëtar</td></tr>
<tr><td><u>Java - XV</u></td><td>Testi i Dytë</td></tr>
<tr><td>LITERA TURA</td><td colspan="2">Literatura themelore:<br><br>1. Prof. Dr. Sabahudin Komoni, Financa, Prishtine, 2014<br>2. Prof. Dr. Drini Salko, Bazat e Financës, Tirane, 2015<br><br>Literatura plotësuese:<br>1. Mishkin, Frederick, (2016). The Economics of Money, Banking, and Financial Markets, 11th edition, Pearson Addison, Wesley.<br>2. Herbert B. Mayo, (2015). Basic Finance: An Introduction to Financial Institutions, Investments, and Management. 11th edition.<br>3. Ligjeratat e prezantuara do të shperndahet studentëve.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJËS** | Metodologjia e përdorur në mësimdhënie dhe mësim nxënie do të jetë ajo e praktikave më të mira: ligjërata interaktive, diskutime, detyra kursi, projekte të pavarura, ushtrime, konsultime dhe punime kërkimore në grup. Mësimi do të zhvillohet përmes ligjëratave, detyrave praktike, interpretimeve individuale dhe grupore, vetëvlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohen në aspektet teorike dhe praktike duke i paraqitur materialet në formë audio vizuale përmes kompjuterit, projektorit dhe në tabelë.<br>Në kuadër të këtij semestri janë të paraparë 15 Javë me nga 2 orë ligjërata dhe 1 ushtrime (seminare dhe diskutime), si dhe dy kollokfiume të cilat mbahen brenda 15 ligjëratave të planifikuara (javën e 8 dhe 15). Studimet e rastit dhe detyrat e shtëpisë jipen pas çdo ligjerate për studentët me qëllim që studentët të studiojnë dhe hulumtojnë në kohën e studimeve vetanake.<br>Rezultatet nga aktivitetet e tilla paraqiten dhe diskutohen në javën vijuese. Studentët inkurajohen për të ndjekur zhvillimet aktuale ekonomike duke lexuar artikuj, revistat ekonomike si dhe materiale të tjera relevante. Ata mund të identifikojnë çështjet/temat e radhës për diskutim nga lexime të tilla. Esetë e përgatitura nga studentët gjithashtu do të diskutohen si dhe inkurajohen prezantimet individuale dhe grupore. |

**Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)**

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime | 1 | 15 | 15 |
| Konsultime me mësimdhënësin/asistenten | 1 | 12 | 12 |
| Kolokiume /seminare | 3 | 3 | 9 |
| Detyra të pavarura | 1 | 15 | 15 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 4 | 15 | 60 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 8 | 16 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 2 | 5 | 10 |
| Projektet, prezantimet, etj | 2 | 5 | 10 |
| **Totali** | | | **177 orë** |

| | |
|---|---|
| **VLERËSIMI** | **Metodat e vlerësimit**<br><u>Vlerësimi në %</u><br>Testi i –I-rë, me shkrim .................................. 40%<br>Testi i – II-të, me shkrim ................................. 40%<br>Pjesmarrja në ligjerta dhe ushtrime .......... 10%<br>Punime seminarike..............................................10%<br>Povimi me shkrim ...............................................100%<br><br>**Shkallët e notave** :<br>50-me pak – nota 5 (pesë)<br>51-60 % - nota 6 (gjashtë)<br>61-70 % - nota 7 (shtatë)<br>71-80 % - nota 8 (tetë)<br>81-90 % - nota (nëntë)<br>91-100 % - nota (dhjetë) |
| **POLITIKAT AKADEMIKE** | Studentët pritet të marrin pjesë rregullisht në ligjërata. Ata pritet gjithashtu të jenë aktiv në ligjërata, seminare dhe diskutimeve individuale dhe grupore. Profesori është në dispozicion për konsultime individuale. Studentët janë të detyruar për të lexuar literaturë para çdo ligjërate. Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera te universitetit. Kodi e mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit. |

**Mitrovicë**

15/09/<u>2021</u>

**Bartës/e i/e lëndës:**

**Prof. Asoc. Dr. Qazim TMAVA**

___________________________

(Emër Mbiemër)

___________________________

(Nënshkrimi)